



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura III
Sesioni pranveror

Kryesia e Kuvendit

P-018

Prishtinë, më 12 maj 2008, në orën 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla C-301

PROCESVERBAL

**I MBLEDHJES SË KRYESISË SË KUVENDIT ME KRYETARËT E GRUPEVE
PARLAMENTARE, TË MBAJTUR MË 12 MAJ 2008**

Në mbledhje morën pjesë: Jakup Krasniqi, kryetar i Kuvendit dhe anëtarët e Kryesisë: Sabri Hamiti, Eqrem Kryeziu, Nexhat Daci, Ibrahim Gashi, Naim Maloku, Sllobodan Petroviq dhe Xhezair Murati, kurse mungoi (me arsye) Xhavit Haliti;

Nga grupet parlamentare: Ramë Manaj, Ibrahim Makolli, Ardian Gjini, Bojan Stojanoviç dhe Zylfi Merxha.

Munguan: Lulzim Zeneli dhe Lutfi Haziri;

Në mbledhje ishin të pranishëm:

Nga Administrata e Kuvendit: Ismet Krasniqi, Daut Beqiri, Sali Rexhepi, Thëllënza Arifi dhe Shefqet Rexhepi;

Nga OSBE-ja: Floriana Shala dhe

Nga NDI: Rinor Beka.

Mbledhjen e kryesoi **Jakup KRASNIQI**, kryetar i Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Kryetari hapi mbledhjen dhe i njoftoi të pranishmit me propozimin e rendit të ditës, si dhe me materialet e shpërndara për këtë mbledhje.

Kryesia, me propozimin e Kryetarit, miratoi këtë

Rend dite

1. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të Kryesisë, të mbajtura më 22 dhe 29 prill 2008,
2. Propozimi i rendit të ditës për seancën plenare më ___ maj 2008
3. Shqyrtimi i mocioneve, i rekomandimeve dhe i kërkesave
 - 3.1 Shqyrtimi i propozimit të Qeverisë për emërimin e anëtarit të Bordit të Autoritetit Qendror Bankar të Republikës së Kosovës,
 - 3.2 Shqyrtimi i propozimit të Qeverisë për ndarjen e mjeteve financiare për Ministrinë e Punëve të Jashtme,
 - 3.3 Shqyrtimi i rekomandimit të Komisionit për Shërbime Publike, Administratë Lokale dhe Media për emërimin e anëtarëve të Këshillit të RTK-së,
 - 3.4 Shqyrtimi i propozimit të Grupit Parlamentar të LDK- së për zëvendësimin e anëtarëve në komisionet parlamentare,
 - 3.5 Shqyrtimi i propozimeve të grupeve parlamentare për emërimin e anëtarëve të Këshillit të Agjencisë Kundër Korrupsionit,
 - 3.6 Shqyrtimi i kërkesës së Komisionit për Punë të Jashtme lidhur me nismën për anëtarësimin e Kuvendit të Republikës së Kosovës në Unionin Ndërparlamentar,
 - 3.7 Shqyrtimi i kërkesës së Komisionit për Integritet Evropian për lejimin e udhëtimit zyrtar në Bruksel,
 - 3.8 Shqyrtimi i kërkesës së këshilltarit të Kryetarit të Kuvendit, Ismet Hajrullahu, për lejimin e udhëtimit zyrtar në Bruksel,
 - 3.9 Shqyrtimi i kërkesës së sekretarit të Kuvendit për lejimin e mjeteve shtesë për blerjen e një veture për anëtarin e Kryesisë së Kuvendit.
4. Të ndryshme
 - 4.1 Njoftimi me raportin vjetor të Komisionit për Ndihmë Juridike,
 - 4.2 Njoftimi me Memorandumin e Bashkëpunimit ndërmjet Kuvendit të Republikës së Kosovës dhe Institutit Demokratik Kombëtar të SHBA-ve.

1. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të Kryesisë, të mbajtura më 22 dhe 29 prill 2008

Procesverbalet e mbledhjeve të Kryesisë së Kuvendit, të mbajtura më 22 dhe 29 prill 2008 u miratuan pa vërejtje.

2. Propozimi i rendit të ditës për seancën e ardhshme plenare

Kryetari i informoi anëtarët e Kryesisë dhe kryetarët e grupeve parlamentare me materialet e përgatitura për seancën e radhës. Ai kërkoi pëlqimin e tyre për secilën pikë të rendit të ditës, veç e veç.

Kryesia, pasi shqyrtoi përgatitjet e nevojshme, me pëlqimin e kryetarëve të grupeve parlamentare, vendosi që seanca e radhës të mbahet më 16 maj 2008, në orën 10:00, me këtë

R e n d d i t e:

1. Miratimi i procesverbaleve të seancave plenare të mbajtura më 18 e 21 dhe më 29 prill 2008,
2. Koha për pyetjet parlamentare,
3. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për pyjet,
4. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për kualifikimet kombëtare,
5. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për procedurën jokontestimore,
6. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për procedurën përmbaruese,
7. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për përkrahje materiale familjeve të fëmijëve me aftësi të kufizuara të përhershme,
8. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për përdorimin civil të eksplozivëve.

Në vazhdim, Kryesia i zhvilloi punimet pa praninë e kryetarëve të grupeve parlamentare.

3. Shqyrtimi i mocioneve, i rekomandimeve dhe i kërkesave

3.1 Shqyrtimi i propozimit të Qeverisë për emërimin e anëtarit të Bordit të Autoritetit Qendror Bankar të Republikës së Kosovës

Kryetari i njoftoi anëtarët e Kryesisë me propozimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës për emërimin e anëtarit të Bordit të Autoritetit Qendror Bankar të Kosovës.

Kryesia, me propozimin e Kryetarit, vendosi që propozimin e Qeverisë për emërimin e anëtarit të Bordit të Autoritetit Qendror Bankar të Kosovës ta radhisë në rend dite të seancës plenare të 16 majit 2008.

3.2 Shqyrtimi i propozimit të Qeverisë për ndarjen e mjeteve financiare për Ministrinë e Punëve të Jashtme

Kryetari i informoi anëtarët e Kryesisë se Qeveria ka propozuar lejimin e mjeteve financiare për Ministrinë e Punëve të Jashtme nga Buxheti i Konsoliduar i Kosovës për vitin 2008 dhe e njëjta ka kërkuar nga Kuvendi miratimin e tij.

Kryesia, pasi shqyrtoi kërkesën e cekur më lart, nxori këtë

P ë r f u n d i m

Kërkohet nga Komisioni për Buxhet e Financa dhe Komisioni për Punë të Jashtme që ta shqyrtojë propozimin e Qeverisë për lejimin e mjeteve financiare për Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Kuvendit t'ia paraqesin rekomandimet lidhur me të.

3.3 Shqyrtimi i rekomandimit të Komisionit për Shërbime Publike, Administratë Lokale dhe Media për emërimin e anëtarëve të Bordit të RTK-së

Kryetari i informoi anëtarët e Kryesisë me rekomandimin e Komisioni për Shërbime Publike, Administratë Lokale dhe Media, me të cilin kishte konstatuar se lista e propozuar nga Komisioni i Pavarur për Media për emërimin e anëtarëve të Bordit të RTK-së nuk është në pajtim me nenin 24 të Ligjit për RTK-në.

Sabri Hamiti propozoi që të përsëritet konkursi për anëtarët e Bordit të RTK-ës dhe të formohet një Komisioni Ad- Hoc i Kuvendit për shqyrtimin e listës së kandidatëve të propozuar, me arsyetimin se kjo listë është propozuar nga legjislatura e mëparshme.

Kryesia, me propozimin e Sabri Hamitit, nxori

P e r f u n d i m

Kërkohet nga Komisioni i Pavarur për Media që në afatin sa më të shkurtër të mundshëm të ri-procedojë me shpalljen publike për zgjedhjen e kandidatëve për anëtarë të Bordit të RTK-ës, meqë lista e propozuar me parë i është adresuar Kuvendit nga legjislatura e mëparshme.

3.4 Shqyrtimi i propozimit të Grupit Parlamentar të LDK- së për zëvendësimin e anëtarëve në komisionet parlamentare

Kryesia u njoftua me propozimin e Grupit Parlamentar të LDK-së me të cilin kishte propozuar që t'i zëvendësojë anëtarët në Komisionin për Integritet Evropian dhe në Komisionin për Legjislacion dhe Gjyqësi, nga radhët e veta.

Kryesia vendosi që propozimi Grupit Parlamentar të LDK-së të radhitet për shqyrtim në rend dite të seancës plenare më 16 maj 2008.

3.5 Shqyrtimi i propozimeve të grupeve parlamentare për emërimin e anëtarëve të Këshillit të Agjencisë Kundër Korrupsionit

Kryesia, pasi u njoftua me propozimet e kandidatëve të grupeve parlamentare për emërimin e anëtarëve të Këshillit të Agjencisë Kundër Korrupsionit, vendosi që ato të radhiten për shqyrtim në seancë plenare të 16 majit 2008.

3.6 Shqyrtimi i kërkesës së Komisionit për Punë të Jashtme lidhur me nismën për anëtarësimin e Kuvendit të Republikës së Kosovës në Unionin Ndërparlamentar

Kryesia, pasi u njoftua me kërkesën e Komisionit për Punë të Jashtme lidhur me nismën për anëtarësimin e Kuvendit të Republikës së Kosovës në Unionin Ndërparlamentar, shtyu këtë nismë për më vonë, pasi të analizohen rrethanat dhe mundësitë për anëtarësim.

3.7 Shqyrtimi i kërkesës së Komisionit për Integritet Evropian për lejimin e udhëtimit zyrtar në Bruksel

Kryetari i informoi anëtarët e Kryesisë me kërkesën e Komisionit për Integritet Evropian për lejimin e udhëtimit zyrtarë në Bruksel.

Kryesia, pasi shqyrtoi kërkesën e cekur më lart, mori këtë

VENDIM

1. Lejohet udhëtimi zyrtar i delegacionit të Kuvendit, në Bruksel, Belgjikë, prej 28 deri më 29 maj 2008.
2. Shpenzimet e qëndrimit, udhëtimit dhe mëditjet për delegacionin i përballon Buxheti i Kuvendit.

3.8 Shqyrtimi i kërkesës së këshilltarit të Kryetarit të Kuvendit, Ismet Hajrullahu, për lejimin e udhëtimit zyrtar në Bruksel

Kryesia, pasi e shqyrtoi kërkesën për udhëtimin zyrtar të delegacionit të Kuvendi të Kosovës për në Bruksel, mori këtë

V E N D I M

1. Lejohet udhëtimi zyrtar në Bruksel, Belgjikë prej 14 deri më 15 maj 2008, i delegacionit të Kuvendit, në përbërje: Ramadan Avdiu, Lutfi Haziri, Zylfie Hundozi, Njomza Emini, Slobodan Petroviq, Enis Kervan- deputet të Kuvendit dhe i Ismet Hajrullahut dhe Adelina Demollit – nga Administrata.
2. Shpenzimet e qëndrimit, udhëtimit dhe mëditjet për delegacionin rimburohen nga organizatori.

3.9 Shqyrtimi i kërkesës së sekretarit të Kuvendit për lejimin e mjeteve shtesë për blerjen e një veture për anëtarin e Kryesisë së Kuvendit

Kryesia, pasi e shqyrtoi kërkesën e sekretari për lejimin e mjeteve shtesë për blerjen e një veture, mori këtë

VENDIM

1. Miratohet kërkesa për lejimin e mjeteve shtesë për blerjen e veturës për anëtarin e Kryesisë së Kuvendit.
2. Shuma prej 5.900€ të bartet nga kategoria e mallrave dhe shërbimeve e Buxhetit të Kuvendit në vendimin për blerjen e veturave.

3.10 Shqyrtimi i kërkesës së delegacionit të Kuvendit të Kosovës për lejimin e udhëtimit në Slloveni

Kryesia, pasi shqyrtoi kërkesën e delegacionit të Kuvendit të Kosovës për lejimin e udhëtimit në Slloveni, mori këtë

V E N D I M

1. Lejohet udhëtimi zyrtar në Slloveni prej 12 deri më 15 maj 2008, i delegacionit të Kuvendit, në këtë përbërje: Jakup Krasniqi, Kryetar i Kuvendit, Xhavit Haliti, Sabri Hamiti, Nexhat Daci, Slobodan Petrović, anëtarë të Kryesisë dhe i Mehmet Hajrizi e Ilir Gashi – këshilltarë të kryetarit të Kuvendit.
2. Shpenzimet e qëndrimit, të udhëtimit dhe mëditjet për delegacionin e Kuvendit, përballohen nga buxheti i Kuvendit.

3.11 Shqyrtimi i kërkesës së Komisionit për Punë të Brendshme dhe Siguri për lejimin e udhëtimit në Gjenevë

Kryesia u njoftua me kërkesën e Komisionit për Punë të Brendshme dhe Siguri, i cili ishte ftuar të marrë pjesë në një Tryezë të rrumbullakët, e cila do të mbahet në Gjenevë, Zvicër, prej 2 deri 4 qershor 2008.

Kryesia, pasi shqyrtoi kërkesën e cekur më lart, mori këtë

V E N D I M

1. Lejohet udhëtimi zyrtar i anëtarëve të Komisionit për Punë të Brendshme dhe Siguri në Gjenevë, Zvicër, prej 2 deri më 4 qershor 2008, në këtë përbërje : Shkumbin Demaliaj, Bojan Stojanović, Emrush Xhemajli, Naim Maloku, Zylfi Merxha, Gani Geci, Zafir Berisha dhe Agim Veliu, dhe Nur Çeku e Biljana Petrovic nga Administrata e Kuvendit.
2. Shpenzimet e qëndrimit, të udhëtimit dhe mëditjet nga paragrafi 1 i këtij vendimi i përballon organizatori.

4. Të ndryshme

4.1 Njoftimi me raportin vjetor të Komisionit për Ndihmë Juridike

Kryesia u njoftua me Raportin vjetor të Komisioni për Ndihmë Juridike, i cili duhet t'u shpërndalet deputetëve të Kuvendit.

4.2 Njoftimi m e Memorandumin e Bashkëpunimit ndërmjet Kuvendit të Republikës së Kosovës dhe Institutit Demokratik Kombëtar të SHBA-ve

Kryesia u njoftua me Memorandumin e Bashkëpunimit ndërmjet Kuvendit dhe NDI-s, që konsiston në fushat e bashkëpunimit, duke përfshirë edhe vlerësimin e përgjithshëm të punës së Kuvendit.

4.3 Kërkesa e deputetes Radmila Vujović për ndarjen e mjeteve financiare për partitë politike

Anëtari i Kryesisë, **Slobodan Petrović**, shpjegoi kërkesën e deputetes Vujović, e cila në zgjedhje e 17 nëntorit 2007 për deputete në Kuvendin e Kosovës kishte fituar si anëtare e Partisë Demokratike

Serbe, kurse më vonë ajo kishte kaluar në Partinë Liberale të Pavarur. Mjetet financiare që Kuvendi i ka ndarë për financimin e partive politike, të përfaqësuara në Kuvend, janë ndarë sipas numrit të deputetëve që ato kanë në Kuvend. Prandaj, pasi që ajo e ka ndërruar partinë, tani kërkon që mjetet që janë ndarë për te, e që janë derdhur në fondin e Partisë Demokratike, të barten në fondin e Partisë Liberale të Pavarur.

Kryesia, pasi shqyrtoi kërkesën e cekur më lart, nxori këtë

P ë r f u n d i m

Të konsultohen zyrat përkatëse të OSBE-së dhe të UNMIK-ut lidhur me mënyrën e rindarjes së mjeteve, sipas kërkesës së deputetes Radmila Vujoviq.

Kryetari e deklaroi mbledhjen të mbyllur në orën 11:30 minuta.

Kryetari i Kuvendit
Jakup KRASNIQI

E hartoi:

Divizioni i Çështjeve Plenare dhe Procedurale